

Bujqësia e Kosovës në Numra

2023



Hyrja

Dokumenti "Kosova Bujqësia në Numra 2023" ofron një pasqyrë të përmbledhur të treguesve statistikorë thelbësorë që kanë të bëjnë me sektorin e bujqësisë, duke ofruar një portretizimi më të qasshëm të trendëve aktuale zhvillimore në bujqësi. Përgatitur nga Departamenti i Analizës Ekonomike dhe Statistikave Bujqësore, ky publikim lehtëson qasjen e shpejtë dhe të lehtë për përdoruesit në një sërë të dhënash të larmishme, duke përfshirë statistika të përgjithshme si Produkti i Brendshëm Bruto, popullsia dhe shkalla e papunësisë. Përveç kësaj, mbulon statistikave kryesore bujqësore specifike për Kosovën, duke theksuar kontributin e sektorit në PBB, dinamikën tregtare të produkteve bujqësore, bilancin tregtar dhe të dhënat e përdorimit të tokës.

Për më tepër, publikimi thellohet në llogaritë ekonomike, duke përfshirë produktet e industrisë bujqësore dhe komponentë të tjerë thelbësorë ekonomikë. Publikimi përfshin gjithashtu të dhëna për çmimet e inputeve dhe produkteve bujqësore, prodhimin bujqësor dhe blegtoral, duke përfshirë prodhimin bimor, prodhimin e verës dhe treguesit e blegtorisë nga bilancet e furnizimit. Dokumenti shtrihet në statistikave të tregtisë për produktet bujqësore të kategorizuara sipas grupeve të produkteve dhe vendeve. Për më tepër, ai përfshin të dhëna për agrokreditë dhe mbështetjen për sektorin e bujqësisë dhe zhvillimin rural, duke përfshirë pagesat direkte dhe masat e zhvillimit rural.

Ngjarjet e viteve të fundit si pandemia COVID-19, lufta në Ukrainë dhe vendet e Lindjes së Mesme si dhe konflikte të tjera kanë nxjerrë në pah nevojën urgjente për statistika të sakta në mënyrë që të mund të japim përgjigje në kohë dhe të monitorojmë tendencat e zhvillimit për sigurinë ushqimore në nivel kombëtar gjatë formulimit të politikave për zhvillimin sektorial të bujqësisë në Kosovë. Prandaj, Departamenti i Analizave Ekonomike dhe Statistikave Bujqësore (DEAAS) është i përkushtuar që të sigurojë qasje në të dhënat aktuale, të besueshme dhe në kohë të nevojshme për të përcaktuar drejtimin e sektorit të bujqësisë. Burimi i informacionit në publikim janë njësitë organizative të MBPZHR-ës, Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë (AZHB) dhe Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK).

Përmbledhje

Bazuar në konfiguracionin gjeografik dhe kushtet klimatike, Kosova ka kushte dhe potencial për zhvillimin e bujqësisë duke marr parasysh se afro gjysma e territorit apo 420,482 ha është e cilësuar si sipërfaqe e shfrytëzuar e tokës bujqësore. Në vitin 2022, bujqësia së bashku me pylltarinë kontribuan me 7.4 % në vlerën totale të Bruto Produktit Vendor dhe afro 23% në punësimin total. Në vitin 2022 vlera e Bruto Produktit Vendor me çmime aktuale ishte 8,936 mil. €, me BPV për kokë banori në vlerë 4,486 €. Shkalla e papunësisë në nivel vendi ishte 20.7%. Në vitin 2022 gjithsej sipërfaqja e shfrytëzuar e tokës bujqësore ishte 420,482 ha, dhe paraqitet me këtë strukturë të kategorizimit në përqindje si në vijim: Livadhe dhe kulloza (përfshirë tokën e përbashkët) me pjesëmarrje prej 52%, Tokë e punëshme-ara 45%, Perime (në fushë të hapur dhe serra si kulturë e parë), kopshte dhe fidanishte 2%, Plantacione të pemëve 2% si dhe Plantacione të vreshtave 1%. Sipas Anketës së fundit të Ekonomisë Bujqësore 2022 ka pasur rritje të sipërfaqes së shfrytëzuar të tokës bujqësore vetëm për 0.04% krahasuar me vitin 2021. Rritje me e madhe paraqitet në sipërfaqet me perime në serra për 3.74 %, fidanishte për 7.14 %, plantacione të pemëve 2.3% dhe vreshtave me 0.03 % si dhe perimet në fushë të hapur 1.10 %.

Sa i përket ndërmarrjeve të agrobizneseve në Kosovë për vitin 2022, llogariten gjithsej 3,164 ndërmarrje aktive me numër të të punësuarve gjithsej 17,178 persona, dhe me qarkullim monetar prej 888.7 mil. €.

Bazuar në aktivitete të bizneseve bujqësore për vitin 2022, prinë aktiviteti i përpunimit të produkteve ushqimore me qarkullim prej 490.2 mil. €, pasuar nga aktiviteti i prodhimit të pijeve, me qarkullim prej 156.5 mil. €, aktiviteti i prodhimit bimor dhe shtazor, gjuetia dhe shërbimet e lidhura me to me qarkullim prej 92.3 mil. €, prodhimi i drurit dhe i produkteve të drurit dhe të tapës, përveç mobilieve me qarkullim prej 86.0 mil. €, prodhimi i letrës dhe produkteve të letrës, me qarkullim prej 43.3 mil. €, prodhimi i lëkurës dhe produkteve të lëkurës 11.6 mil. €, pasuar nga aktivitetet tjera si pylltari dhe prerja e drunjtëve me qarkullim prej 5.8 mil. € dhe peshkimi dhe akuakultura me qarkullim prej 3.0 mil. €.

Bazuar në Llogaritë Ekonomike për Bujqësi 2022 del se vlera e prodhimeve bimore dhe blegtorale me çmime aktuale, Prodhimet bimore për vitin 2022 llogariten 654 mil. €, apo vlerë 23% më e lartë krahasuar me vitin 2021 (532 mil. €), kjo rritje i dedikohet rritjes

së vlerës së prodhimit të drithërave, bimëve foragjere, perimeve dhe prodhimeve të kopshtit, si dhe pemëve dhe patateve. Kurse, sa i përket prodhimeve blegtorale vlera e tyre llogaritet 315 mil. €, apo 14% më e lartë krahasuar me vitin 2021 (277 mil. €).

Nëse i referohemi figurës së mëposhtme ku paraqiten vlerat e prodhimeve bimore dhe blegtorale për periudhën 5 vjeçare, vërehet se viti 2022 është viti me vlerat më të larta sa i përket prodhimeve bimore dhe prodhimeve blegtorale, qe ishte 969 mil. €, nga e cila vlera e prodhimeve bimore arriti në 654 mil. €, ndërsa vlera prodhimtarisë blegtorale 315 mil. €, ku njëherit paraqitet edhe si vit, ku vlera e prodhimtarisë bimore ishte më e larta për periudhën 2018-2022. Vlera e prodhimit të industrisë bujqësore në vitin 2022 arriti në 1,016 mil. € dhe ishte vlera më e lartë gjatë periudhës në fjalë, e në krahasim me vitin paraprak dhe shënoi rritje për 19%, përderisa konsumi i ndërmjetëm paraqitet me për rritje për 16%. Vlera e shtuar bruto në vitin 2022 arriti vlerën në 622 mil. €, ku krahasuar me vitin paraprak shënoi rritje për 20%, kategoria e konsumit të ndërmjetëm shënoi vlerë prej gjithsej 394 mil. € apo 16% më e lartë se në vitin 2021 që ishte 340 mil. €. Lidhur me të hyrat e agreguara të paraqitura në figurën në vijim, për periudhën 2018-2022, viti 2022 paraqitet si viti me vlerën më të lartë të të hyrave. Ku gjatë këtij viti vlera e shtuar bruto me çmime bazë llogaritet 622 mil. € apo 20% më e lartë se sa në vitin 2021, vlera e shtuar neto me çmime bazë shënoi 484 mil. € apo 24% më e lartë se në vitin 2021 si dhe të ardhurat sipërmarrëse 470 mil. € apo me rritje 25% krahasuar me vitin 2021.

Kur bëhet fjalë për strukturën e konsumit të ndërmjetëm bujqësor për vitin 2022, të dhënat na tregojnë se pjesëmarrje më e madhe në këtë strukturë paraqet kategoria e ushqimit të kafshëve me pjesëmarrje prej 53%, vijuar nga kategoria e plehrave dhe përmirësuesit e tokës me 14%, mallrat dhe shërbimet tjera me 9%, energjia dhe lubrifikantët 7%, shërbimet bujqësore 5%, shpenzimet veterinerë dhe mirëmbajtja e materialeve me nga 3%, produktet për mbrojtjen e bimëve dhe pesticidet 2%, si dhe kategoria e mirëmbajtjes së ndërtesave me pjesëmarrje prej 1%.

Indeksi vjetor i çmimeve të inpleteve bujqësore në vitin 2022, që paraqesin bazën e indeksit të çmimeve të inpleteve marrin pjesë në njërin nga dy grupet kryesore: Mallrat dhe shërbimet aktualisht të konsumuara në bujqësi (konsumi i ndërmjetëm), si dhe Mallrat dhe shërbimet që kontribuojnë në investimet bujqësore (formimi i kapitalit).

Nga të gjitha kategoritë e paraqitura në tabelën në vijim, kategoria me më së shumti rritje të çmimit në vitin 2022, krahasuar me vitin 2021 është ajo e plehrave të thjeshta brenda kategorisë së plehrave dhe përmirësuesve të tokës për 91.0% dhe plehrave të

përbëra me 72.9%. Gjithashtu rritje e theksuar është shënuar edhe tek energjia dhe lubrifikantët për 32.9% dhe lëndë për ushqim të kafshëve për 29.4%. Rënie të çmimit nuk ka pasur në asnjë kategori të inputeve.

Indeksi vjetor i inputeve në vitin 2022 ka shënuar ngritje për 31.5% për Input 1, krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2021, ndërsa indeksi për Input 2 kishte rritje për 10.7%. Indeksi i çmimeve të inputit të përgjithshëm (Input 1 + Input 2) krahasuar me vitin e 2021, në vitin 2022 është ngrit për 21.7%. Në vitin 2022, disa çmime mesatare të prodhimeve bujqësore në nivel ferme shënuan rënie krahasuar me vitin 2021: spinaqi 25.9%, mjedëra 10.9%, kumbulla 3.7%, dredhëza 2.5 dhe molla dhe dardha me nga 2.3 dhe 2.2%, ndërsa ngritje më të madhe në çmime nga prodhimet kanë shënuar: pulë ferme 65.1%, kungulli 56.3%, gruri 45.0%, mjalti 26.4%, misri 14.3% etj.

Kur bëhet fjalë për **prodhimin bujqësor** të vitit 2022, sipërfaqja totale e mbjellur me drithëra në vitin 2022 ishte 124,618 ha, që ka shënuar rritje për 140 ha më shumë se sa në vitin 2021. Si edhe vitet tjera edhe gjatë vitit 2022 sipërfaqen më të madhe të drithërave e përbëjnë dy kulturat kryesore që janë gruri dhe misri, 64% apo 79,984 e sipërfaqes totale të drithërave ishte e mbjellur me grurë dhe 32% apo 39,797 ha ishin të mbjellura me misër. Drithërat tjera si elbi, thekra, tërshëra dhe grupi tjetër i drithërave kokërr kishin sipërfaqe më të vogla. Sa i përket prodhimtarisë, prodhimi i grurit dhe misrit është rritur për 2.8%, prodhimi i elbit dhe tërshërës për 4.8%, i thekrës për 5.8% dhe drithërave të tjera kokërr për 12.5%. Kjo rritje ishte më shumë si rezultat i rritjes së rendimentit por edhe asaj se sipërfaqet shënuan një rritje të vogël.

Gjatë vitit 2022, llogariten gjithsej 19,571 ha sipërfaqet me perime të kultivuara në fushë të hapur, në serra dhe në kopshte. Kulturat të cilat përbëjnë pjesën më të madhe të kësaj sipërfaqe janë: patatja, speci, kungulli, fasulja, qepa, shalqiri, lakra, si dhe kulturat tjera perimore. Nëse analizohet ndryshimi mes vitit 2021 dhe 2022, sa i përket gjithsej sipërfaqes me perime vërehet se ka një rritje për 0.9%. Kulturat perimore kanë shënuar rritje të lehtë në sipërfaqe, përpos, rrepkës, bizeles dhe bishtajoreve të tjera të cilat kanë shënuar zvogëlim të sipërfaqeve.

Gjatë vitit 2022 në Kosovë janë mbjellë gjithsej 10,619 ha me pemë, apo 2.3% më shumë se sa në vitin 2021. Kjo sipërfaqe njëherit shënon sipërfaqen më të madhe të mbjellë me pemë në vitet e fundit (2018-2022), ku mesatarja e gjithsej e sipërfaqeve të mbjella me pemë për këtë periudhë ishte 9,512 ha.

Fondi i gjedheve në vitin 2022 ishte 250,899 krerë, që përbënë 47.2% të gjithsej numrit të kafshëve, në krahasim me vitin paraprak ku lopët qumështore përfaqësojnë 52% të numrit të përgjithshëm të gjedheve, ndërsa fondi i dhenve dhe dhive ishte 233,488 krerë, që e përbën 43.9% të gjithsej numrit të kafshëve. Nga totali i fondit të dhenve dhe dhive pjesa dërmuese prej 87.4% apo 204,110 i takojnë grupit të dhenve, ndërsa pjesa tjetër prej 12.6% apo 29,378 krerë i takojnë grupit të dhive.

Nga fondi total i kafshëve, fondi i derrave (45,420 krerë), ka pjesëmarrje prej 8.5%. Numri i kuajve, gomarëve dhe mushkave në vitin 2022 është 1,469 krerë që ka pësuar ulje për 21.2% apo 395 krerë më pak se sa në vitin 2021.

Numri i përgjithshëm i shpezëve në vitin 2022 ka pësuar ulje për 6.2%, apo 174 mijë shpezë më pak se në vitin e kaluar. Numri i pulave për vezë ka pësuar ulje për 5.5% në krahasim me vitin e kaluar. Në vitin 2022, gjithsej prodhimi i vezëve vlerësohet të jetë 363 mil. Vezë, ku konsumi mesatar për kokë banori llogaritet të jetë rreth 206 vezë/vit. Në vitin 2021 numri i koshereve u zvogëlua për 43,464 koshere, për faktin se kolonitë e bletëve u shembën pasi dimri ishte jashtëzakonisht i ftohtë dhe i gjatë. Kjo përbën edhe kërcënimin kryesor për familjet e bletëve pasi që lidhet me praktikën intensive të bujqësisë dhe ushqimin e dobët për bletët. Përveç kësaj, ato sulmohen nga viruset, patogjenët dhe speciet pushtuese.

Bletaria që nga viti 2021 është përballur me zvogëlimin e numrit të koshereve të bletëve, trend ky që vazhdoi edhe në vitin 2022 ku në raport me vitin 2021 janë 22,955 koshere më pak apo 10.5%, pasi që kushtet klimatike të vitit 2021 dhe 2022 ishin mjaft të papërshtatshme për zhvillimin e tyre. Sasia e importit varet nga prodhimtaria vendore në vitin përkatës e kjo reflektohet edhe tek shkalla e vetëmjaftueshmërisë për prodhime bujqësore e cila për disa nga prodhimet bujqësore ndër më të kultivuarat në vitin 2021 paraqiten si në vijim: Drithra (grur 69.7% dhe miser 81%), Perime (Domate 64.1%, Spec 86.5%, Patate 94%) dhe Pemishte e Vreshta (Molla 78.5%, Kumbulla 97.8%, Dredhëza 62.5%, Rrush tryeze 74%). Në sektorin e blegtorisë prodhimi i mishit të gjedhit e ka shkallën e vetëmjaftueshmërisë 40.1%, qumështi i lopës 81%, vezët 99% dhe mishi i pulës 7.5% dhe mjaltë 88%. Vlera e eksportit të produkteve bujqësore në vitin 2022 vlera e eksportit të produkteve bujqësore ishte 118.9 mil. €, që paraqet rritje prej 28.4% në krahasim me vitin paraprak. Bilanci tregtar vazhdon të jetë negativ pasi që vlera e importit në vitin 2022 ishte rreth 1.2 mld. €, me rritje prej 24.0% në krahasim me vitin 2021. Edhe në vitin 2022 bilanci tregtar vazhdon të jetë negativ, me vlerë prej 1.1 mld. €, ndërsa sa i përket shkallës së mbulueshmërisë së importit me eksport, në vitin 2022 ishte në shkallë prej 9.9%. Vlera më e lartë e eksportit sipas grupeve të shteteve për vitin 2022 ishte në vendet e CEFTA-s me 55%, pasuar nga vendet e BE-së me 35%

dhe vendet e tjera me 10%. Ndërsa vlera më e lartë e importit ishte nga grupi vendet e BE-së me 48% pasuar nga vendet e CEFTA-s dhe vendet tjera me nga 26% secili.

Gjatë vitit 2022, gjithsej shuma e agro kredive të disbursuara është 496.8. mil. €, ndërsa normat e interesit ndryshojnë nga 5.6% deri në 28.6%, bazuar në shumën e kredisë dhe afatin e kthimit. Pjesëmarrja e kredive në bujqësi në krahasim me kredi të tjera, nëpër Banka dhe IMF dallon. Te Bankat, deklarimi i pjesëmarrjes është nga 0.4% deri në 11.5%. Te IMF-të, deklarimi i pjesëmarrjes varion nga 16.5% në 38% që si mesatare është mbi 23%. Mbështetja e bujqësisë ka vazhduar edhe në vitin 2022 përmes programit Programit të Pagesave Direkte dhe Programit të Zhvillimit Rural. Përmes Programit të Pagesave Direkte janë realizuar 57.5 mil. €, që në raport me vitin 2021 mbështetja pothuajse është dyfishuar. Sektorët për të cilët është shpenzuar pjesa më e madhe e buxhetit në vitin 2022 (75.5% e buxhetit total) janë: gruri, misri, lopët qumështore, bletët dhe perimet ndërsa pjesa tjetër prej 25% është shpenzuar në sektorët e tjerë. Nga gjithsej numri i aplikuesve prej 28,981 fermerë, në vitin 2022, 95% (27,646) ishin aplikues meshkuj dhe 5% (1,335) aplikues femra. Nga buxheti total për mbështetjen e këtyre masave dhe nën-masave përmes Programit të Zhvillimit Rural në kuadër të PZHR-së, në vitin 2022 kanë përfituar gjithsej 491 persona dhe shuma e aplikuar për projekte e miratuara ishte gjithsej 38.8 mil. €, shuma e miratuar ishte 35.9 mil. €, ndërsa shuma për pagesë (përkrahja publike) për këto projekte ishte gjithsej 24.2 mil. €.

Sipas masave shuma e paguar dhe numri i përfituesve ishte: për Masën 1 ishin gjithsej 382 përfitues dhe shuma për pagesë ishte 20.2 mil. €, Masa 3 kishte gjithsej 6 përfitues dhe shuma për pagesë ishte 995,238 €, Masa 5 kishte 6 përfitues dhe shuma për pagesë ishte 59,695 € dhe Masa 7, kishte gjithsej 97 përfitues dhe shuma për pagesë ishte 3 mil. €.

Statistikat e përgjithshme

Të dhënat e përgjithshme për Kosovën					
	2018	2019	2020	2021	2022
Bruto produkti vendor me çmime aktuale (mil. €)	6,672	7,056	6,772	7,958	8,936
BPV për kokë banori (€)	3,715	3,959	3,772	4,486	5,037
Popullsia e Kosovës (e vlerësuar)	1,795,666	1,782,115	1,798,188	1,773,971	-
Shkalla e papunësisë (%)	29.6	25.7	25.9	20.7	12.6

Burimi: ASK

Statistikat kryesore për bujqësinë në Kosovë

Bujqësia në ekonominë e vendit					
	Ø 2006-10	Ø 2011-15	Ø 2016-20	2021	2022
Bujqësia, gjuetia, pylltaria dhe peshkimi - Bruto Vlera e Shtuar me çmime aktuale (BVSH), (mil. €)		402.3	479.0	550.9	657.6
Pjesëmarrja e Bujqësisë në BPV (%)		12.1	7.1	6.9	7.4
Eksporti bujqësor (mil. €)	19.1	34.6	62.8	92.6	118.9
Pjesëmarrja e eksportit bujqësor në eksportin e përgjithshëm (%)	10.5	11.2	16.3	12.4	12.9
Importi bujqësor (mil. €)	419.0	594.0	718.1	965.6	1,197.1
Pjesëmarrja e importit bujqësor në importin e përgjithshëm (%)	23.6	23.5	22.5	20.8	21.2
Bilanci tregtar për produkte bujqësore (mil. €)	(399.9)	(559.4)	(655.2)	(872.9)	(1,078.2)


Burimi: ASK

Përdorimi i tokës

Shfrytëzimi i tokës bujqësore					
	2018	2019	2020	2021	2022
Tokë e punueshme - ara	188,359	188,365	188,372	188,375	188,405
- Nga e cila me perime në fushë të hapur (kulturë e parë)	7,818	8,319	8,435	8,491	8,584
- Nga e cila me perime në serra (kulturë e parë)	468	518	547	562	583
Kopshte	1,003	1,122	1,133	1,089	1,080
Plantacione të pemëve	7,687	9,244	10,029	10,144	10,377
Plantacione të vreshtave	3,272	3,367	3,437	3,471	3,472
Fidanishte	109	111	137	140	150
Livadhe dhe kullosa (përfshirë tokën e përbashkët)	218,152	217,932	217,102	217,107	216,998
Gjithsej sipërfaqja e shfrytëzuar e tokës bujqësore	418,582	420,141	420,210	420,327	420,482

Burimi: ASK - Anketa e ekonomive bujqësore '18,'19,'20,'21,'22

SHFRYTËZIMI I TOKËS BUJQËSORE, 2022



Burimi: ASK - Anketa e ekonomive bujqësore, 2022

Llogaritë ekonomike

Prodhimet e industrisë bujqësore me çmime aktuale, mil. €

	2018	2019	2020	2021	2022
Prodhimet bimore	388.3	441.0	477.4	532.0	654.0
Drithërat	84.8	96.8	116.1	125.6	150.8
Bimët foragjere	106.5	113.9	121.0	133.7	163.2
Perimet dhe prodhimet e kopshtit	98.6	123.1	109.1	122.4	146.4
Patatet	27.8	24.3	27.1	40.3	44.5

Pemët	66.5	78.6	99.9	106,5	114.2
Prodhime tjera bimore	4.0	4.2	4.1	3,6	2.9
Blegtoria	140.3	164.7	164.6	142.5	145.2
Gjedhe	73.7	91.0	67.8	62.7	66.9
Dele dhe dhi	21.0	23.3	27.2	25.9	27.8
Derra	16.5	13.8	18.4	18.9	20.7
Shpezë	15.3	17.4	24.0	22.1	18.9
Kafshë të tjera	14.2	19.1	27.2	12.6	11.2
Produktet blegtorale	132.0	129.3	137.9	134.3	154.7
Qumësht	103.2	101.3	107.7	102.8	116.3
Vezë	28.2	28.0	30.1	31.4	38.4
Produktet tjera blegtorale	0.1	0.1	0.1	0.1	0.1

Burimi: ASK - Llogaritë Ekonomike për Bujqësi '18,'19,'20,'21,'22

Komponentët kryesor të llogarive ekonomike me çmime bazike, mil. €					
	2018	2019	2020	2021	2022
Prodhimet e "industrisë" bujqësore	704.7	782.3	828.4	856.4	1,016.0
Konsumi i ndërmjetëm	302.0	305.4	316.3	339.7	394.4
Vlera e shtuar bruto	402.7	476.9	512.1	516.7	621.6
Konsumi i kapitalit fiks	108.2	116.7	121.0	127.8	137.9
Vlera e shtuar neto	294.4	360.3	391.1	389.0	483.7
Subvencionet tjera në prodhim	2.1	0.3	0.2	-	-
Të ardhurat faktor	296.5	360.6	391.1	388.9	-
Të ardhurat sipërmarrëse	280.5	343.5	376.0	376.4	470.2

Burimi: ASK - Llogaritë Ekonomike për Bujqësi '18,'19,'20,'21,'22

Çmimet e inputeve dhe produkteve bujqësore

Indeksi i çmimeve të inputeve bujqësore					
	2018	2019	2020	2021	2022
Mallrat dhe shërbimet e konsumuara aktualisht në bujqësi (Input 1)	94.0	95.8	92.7	103.1	135.6
Farërat dhe materiali mbëltues	78.1	83.7	84.2	83.5	86.4
Energji; lubrifikant	106.5	106.3	92.0	105.2	139.8
Plehrat dhe përmirësuesit e tokës	85.9	88.5	87.3	113.4	203.5
Produktet për mbrojtjen e bimëve dhe pesticidet	105.4	106.3	103.5	105.9	115.7
Shpenzimet veterinare	97.5	99.3	98.0	100.7	104.4
Lëndë për ushqim kafshësh	103.2	107.6	110.1	120.5	155.9
Mirëmbajtja e materialeve	99.8	99.5	99.2	99.5	103.7
Mirëmbajtja e ndërtesave	98.6	99.3	101.5	104.8	113.0
Mallrat dhe shërbimet tjera	100.9	101.4	101.3	105.0	105.9
Mallrat dhe shërbimet që kontribuojnë në investimet bujqësore (Input 2)	102.6	109.9	111.5	116.8	129.4
Traktor	105.2	119.0	120.8	130.6	143.3
Të tjera	100.3	101.8	103.3	104.6	117.1
Inputi i përgjithshëm (Input 1 + input 2)	97.8	102.1	101.1	109.2	132.8

Burimi: ASK - Indeksi i çmimeve të inputeve dhe çmimet në bujqësi 2018-2022 (2015=100), përpunuar nga DAESB - MBPZhR

Çmimet vjetore për energji elektrike dhe naftë, €					
	2018	2019	2020	2021	2022
Energjia elektrike çmimi për 100 kwh	5.8	5.6	5.6	5.7	5.9
Nafta - çmimi për 100 litra	112.7	114.9	92.6	110.2	124.7

Burimi: ASK - Indeksi i çmimeve të inputeve dhe çmimet në bujqësi 2018-2022

Çmimet e prodhimeve bujqësore

Çmimet mesatare vjetore në fermë, €/kg					
	2018	2019	2020	2021	2022
Grurë	0.23	0.18	0.19	0.20	0.29
Misër	0.26	0.22	0.25	0.28	0.32
Domate	0.62	0.57	0.33	0.52	0.66
Fasule	2.27	2.03	2.31	2.38	2.49
Kungull *	0.90	0.81	0.17	0.16	0.25
Kungull misiri *	0.84	0.81	0.22	0.29	0.39
Lakër	0.40	0.19	0.23	0.31	0.36
Patate	0.33	0.27	0.28	0.42	0.49
Qepë	0.37	0.46	0.37	0.41	0.48
Shalqi	0.23	0.19	0.18	0.21	0.21
Spec	0.91	0.76	0.54	0.62	0.78
Spinaq	0.94	0.94	0.76	1.16	0.86
Trangull	0.46	0.48	0.31	0.54	0.67
Arrë	2.72	2.16	2.06	2.13	2.57
Dardhë	0.79	0.81	0.72	0.91	0.89
Dredhëz	1.03	1.12	1.16	1.22	1.19
Kumbull	0.73	0.51	0.71	0.81	0.78
Mjedër	1.67	1.77	1.73	3.50	3.12
Mollë	0.40	0.39	0.31	0.44	0.43
Rrush tryeze	0.78	0.68	0.63	0.53	0.69
Mëzet dhe Mëshqerra	2.14	1.97	2.21	2.53	2.71
Pulë ferme	1.80	1.68	1.72	1.89	3.12
Qumësht	0.25	0.21	0.23	0.31	0.34
Veze **	2.10	2.07	2.26	2.12	2.54
Mjaltë	9.20	11.85	13.60	11.50	14.54

Burimi: DAESB - MBPZhR; *2018-2019 €/copë, 2020-22 €/kg, **njësia 30 copë

Çmimet mesatare vjetore të konsumit, €/kg					
	2018	2019	2020	2021	2022
Grurë	0.28	0.36	0.38	0.36	0.42
Misër	0.48	0.54	0.62	0.46	0.42
Domate	0.84	0.80	0.77	0.94	1.26
Fasule	2.64	2.66	2.60	2.67	3.01
Kungull *	1.19	1.16	0.42	0.34	0.61
Kungull misiri *	1.26	1.22	0.45	0.51	0.75
Lakër	0.59	0.55	0.47	0.55	0.55
Patate	0.43	0.50	0.48	0.49	0.60
Qepë	0.47	0.65	0.64	0.57	0.71
Shalqi	0.40	0.30	0.45	0.28	0.28
Spec	1.17	1.06	1.08	1.08	1.38
Spinaq	1.12	1.18	1.07	1.08	1.08
Trangull	0.61	0.67	0.65	0.86	1.06
Arrë	2.89	2.61	2.56	2.96	3.22
Dardhë	0.94	1.13	1.35	1.45	1.48
Dredhëz	1.89	1.49	1.97	1.87	1.93
Kumbull	0.84	0.75	0.79	1.48	1.08
Mjedër	2.60	2.44	2.26	4.25	3.93
Mollë	0.53	0.60	0.74	0.84	0.69
Rrush tryeze	1.09	0.98	1.09	1.20	1.52
Mëzet dhe Mëshqerra	3.80	3.75	3.02	2.49	3.05
Pulë ferme	2.37	2.33	2.13	2.38	4.51
Qumësht	0.49	0.51	0.48	0.49	0.60
Vezë **	2.45	2.50	2.61	2.57	3.61
Mjaltë	7.50	7.40	7.50	10.77	11.42

Burimi: DAESB - MBPZhR; *2018-2019 €/copë, 2020-22 €/kg, **njësia 30 copë

Çmimet mesatare të importit në treg, €/kg					
	2018	2019	2020	2021	2022
Grurë	0.31	0.38	0.38	0.36	0.35
Misër	0.33	0.53	0.45	0.43	0.32
Domate	0.91	0.97	1.19	0.97	1.36
Fasule	2.03	1.97	2.01	2.36	2.77
Kungull *	1.18	1.12	0.28	0.31	0.41
Kungull misiri *	1.50	0.90	0.46	0.43	0.52
Lakër	0.39	0.56	0.64	0.52	0.44
Patate	0.66	0.55	0.84	0.56	0.70
Qepë	0.39	0.52	0.61	0.55	0.58
Shalqi	0.96	1.61	0.85	0.79	0.89
Spec	1.18	1.46	1.50	1.23	1.86
Spinaq	1.15	1.49	1.19	1.21	0.78
Trangull	0.94	1.08	1.21	1.00	1.12
Arrë	2.44	2.40	2.06	2.42	2.67
Dardhë	1.28	1.34	1.47	1.48	1.36
Dredhëz	2.96	2.69	2.94	2.63	2.30
Kumbull	2.83	3.49	2.34	2.19	1.56
Mjedër	-	1.70	-	-	-
Mollë	0.83	0.78	0.82	0.77	0.72
Rrush tryeze	2.45	2.66	1.97	2.78	2.48
Mëzet dhe Mëshqerra	2.90	3.05	2.87	2.98	2.75
Pulë ferme	2.60	2.35	2.21	2.72	-
Qumësht	-	-	-	-	-
Veze **	2.10	2.35	2.15	2.21	3.31
Mjaltë	8.60	7.85	8.60	7.54	11.39

Burimi: DAESB - MBPZhR; *2018-19 €/copë, 2020-22 €/kg, **njësia 30 copë

Prodhimi bujqësor dhe blegtoral

Prodhimet bimore, ha					
	2018	2019	2020	2021	2022
Drithëra	123,869	124,199	124,714	124,477	124,618
Grurë	81,123	80,273	80,473	79,970	79,984
Misër	38,453	39,441	39,684	39,710	39,797
Perime	17,886	18,911	19,243	19,399	19,571
Patate	3,606	3,688	3,771	3,854	3,884
Spec	3,038	3,108	3,134	3,146	3,154
Fasule	2,845	2,888	2,904	2,914	2,941
Kungull	2,255	2,502	2,577	2,612	2,628
Pemishte	7,922	9,479	10,265	10,382	10,619
Molla	2,556	3,006	3,068	3,083	3,091
Kumbulla	1,821	2,096	2,201	2,210	2,214
Mjedra	1,537	1,637	1,661	1,665	1,668
Arra	608	886	1,295	1,352	1,540
Vreshta	3,272	3,367	3,437	3,471	3,472
Rrush vere	2,455	2,489	2,526	2,533	2,521
Rrush tryeze	816	878	911	938	951
Kultura foragjere	107,099	108,480	108,436	108,560	108,551
Sanë	70,679	70,679	70,717	70,723	70,736
Jonxhë	17,182	18,293	18,329	18,360	18,359
Kultura industriale	329	402	1,065	885	887

Burimi: ASK - Anketa e ekonomive bujqësore '18,'19,'20,'21,'22; MBPZhR - Departamenti për Vreshtari dhe Verëtari (DVV)

Prodhimtaria bimore, t					
	2018	2019	2020	2021	2022
Drithëra	441,757	459,404	529,112	504,371	518,724
Grurë	280,616	284,999	341,818	322,018	330,913
Misër	151,921	163,930	175,180	170,393	175,226
Perime	265,420	300,559	290,555	282,734	295,802
Patate	68,790	73,816	74,508	73,984	75,500
Spec	49,907	59,404	53,889	52,381	55,353
Fasule	5,688	6,713	5,708	5,349	5,597
Kungull	20,208	23,050	22,535	22,326	22,551
Pemishte	53,606	67,294	72,265	67,533	75,713
Molla	26,093	33,835	38,049	37,381	40,028
Kumbulla	10,643	12,745	13,147	11,247	13,284
Mjedra	8,267	7,206	6,659	5,840	6,740
Arra	761	2,028	2,591	2,108	3,100
Vreshta	27,322	19,318	26,330	26,527	23,506
Rrush vere	22,324	14,772	20,049	19,091	16,461
Rrush tryeze	4,998	4,546	6,281	7,435	7,045
Kultura foragjere	480,966	504,406	503,758	481,952	493,955
Sanë	249,559	249,683	247,921	233,323	240,783
Jonxhë	73,754	84,257	85,503	82,330	85,044
Kultura industriale	392	576	1,347	1,022	1,180

Burimi: ASK - Anketa e ekonomive bujqësore '18,'19,'20,'21,'22; DVV - MBPZhR

Prodhimtaria bimore, t/ha		2018	2019	2020	2021	2022
Drithëra	Grurë	3.5	3.6	4.3	4.0	4.1
	Misër	4.0	4.2	4.4	4.3	4.4
Perime	Patate	19.1	20.0	19.8	19.2	19.4
	Spec	16.4	19.1	17.2	16.7	17.6
	Fasule	2.0	2.3	2.0	1.8	1.9
	Kungull	9.0	9.2	8.7	8.6	8.6
	Molla	10.2	11.3	12.4	12.1	13.0
Pemishte	Kumbulla	5.8	6.1	6.0	5.1	6.0
	Mjedra	5.4	4.4	4.0	3.5	4.0
	Arra	1.3	2.3	2.0	1.6	2.0
Vreshta	Rrush tryeze	6.1	5.2	6.9	7.9	7.0
	Rrush vere	9.1	5.9	7.9	7.5	16.5
Kultura foragjere	Sanë	3.5	3.5	3.5	3.3	3.4
	Jonxhë	4.3	4.6	4.7	4.5	4.6

Burimi: ASK - Anketa e ekonomive bujqësore '18,'19,'20,'21,'22; DVV - MBPZhR

Prodhimi i verës, '000 litra		2018	2019	2020	2021	2022
Verë e bardhë		6,234	3,380	5,100	4,744	4,643
Verë e kuqe		5,441	2,325	4,295	3,001	3,140
Verë roze		69	49	35	40	79
Gjithsej verë		11,744	5,754	9,429	7,785	7,862

Burimi: DVV - MBPZhR

Numri i kafshëve, shpezëve dhe bletëve					
	2018	2019	2020	2021	2022
Gjedhe	258,662	257,733	261,389	260,528	250,899
Lopë qumështore	132,474	131,939	133,916	132,076	130,493
Dhen dhe dhi	209,808	216,299	241,688	241,393	233,488
Dhentë	181,105	189,102	212,131	211,354	204,110
<i>Dele për mbarështim</i>	139,312	145,248	159,067	156,666	151,011
Dhi	28,703	27,197	29,557	30,039	29,378
<i>Dhi për mbarështim</i>	22,401	20,602	21,907	22,234	21,663
Derra	40,164	40,533	45,394	47,384	45,420
Dosa	10,188	11,422	12,756	13,502	13,039
Shpezë ('000)	2,538	2,665	2,782	2,788	2,614
Pula ('000)	2,393	2,558	2,637	2,643	2,482
<i>Pula për vezë ('000)</i>	1,728	1,947	1,939	1,996	1,886
Brojler ('000)	407	321	384	346	323
Koshere bletësh	182,476	219,831	262,541	219,077	196,122

Burimi: ASK - Anketa e ekonomive bujqësore '18,'19,'20,'21,'22

Prodhimtaria blegtorale, t					
	2018	2019	2020	2021	2022
Mish gjedhi (p.th)	19,463	19,495	19,738	19,833	19,659.0
Mish pule (p.th)	3,023	2,508	2,671	3,007	3,029
Qumësht lope	277,599	277,138	281,960	278,746	276,058
Veze ('000 copë)	315,097	366,447	365,554	423,640	363,031
Mjaltë	2,737	2,198	788	1,634	1,765

Burimi: DAESB - MBPZHR

Bilancet e furnizimit për prodhime bujqësore

Konsumi për kokë banori për disa prodhime bujqësore, kg		2018	2019	2020	2021	2022
Drithëra	Grurë	200.3	231.9	204.0	207.0	213.0
	Misër	44.7	47.0	49.4	44.0	40.0
Perime	Patate	33.6	38.7	37.6	45.0	45.0
	Spec	33.0	37.9	33.4	34.0	35.0
	Domate	21.5	20.7	19.4	21.0	18.0
Pemishte	Molla	19.1	23.0	27.0	27.0	29.0
	Kumbulla	6.6	8.3	8.5	7.0	9.0
	Dredhëz	1.1	1.0	1.1	1.0	2.0
Vreshta	Rrush tryeze	4.1	4.0	4.9	6.0	5.0
Mish	Mish gjedhi	19.3	20.1	21.0	25.5	27.7
	Mish pule	21.1	22.9	20.9	24.5	22.9
Produkte tjera	Qumësht lope	167.8	171.8	169.6	171.0	165.0
	Vezë (copë)	177.8	208.5	206.0	239.2	206.0
	Mjaltë	1.6	1.4	0.6	1.1	1.1

Burimi: DAESB - MBPZHR


Shkalla e vetëmjaftueshmërisë për disa prodhime bujqësore (%)

		2018	2019	2020	2021	2022
Drithëra	Grurë	63.0	57.0	73.3	69.6	69.7
	Misër	73.9	74.8	75.1	78.0	81.3
Perime	Patate	113.5	106.7	109.9	92.4	94.0
	Spec	82.0	85.6	87.2	84.9	86.5
	Domate	57.5	59.8	56.9	50.8	61.4
Pemishte	Molla	75.7	80.2	77.6	77.6	78.5
	Kumbulla	99.6	95.5	95.1	94.5	97.8
	Dredhëz	75.0	69.1	78.5	73.4	62.5
Vreshta	Rrush tryeze	67.7	57.0	71.0	72.0	74.0
Mish	Mish gjedhi	56.1	54.0	52.2	43.9	40.1
	Mish pule	8.0	6.1	7.1	6.9	7.5
Produkte tjera	Qumësht lope	79.9	78.6	80.1	79.6	81.3
	Veze (copë)	98.7	98.6	99.0	99.0	99.0
	Mjaltë	92.9	90.6	76.0	85.0	88.0

Burimi: DAESB - MBPZHR

Tregtia e produkteve bujqësore


Ekspor, Importi dhe Bilanci tregtar i produkteve bujqësore (1-24), në mil. €



Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB – MBPZHR, të dhënat për vitin 2011 janë preliminare.


*Grupet e mallrave 01-24 të Nomenklaturës së Kombinuar

Pjesëmarrja e produkteve bujqësore në eksportin e përgjithshëm



Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB - MBPZhr

Pjesëmarrja e produkteve bujqësore në importin e përgjithshëm



Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB - MBPZhR

Eksporti i produkteve bujqësore sipas grupeve kryesore (%)

	Ø 2006-10	Ø 2011-15	2016-20	2021	2022
Eksporti (mil. €)	19.1	34.6	62.8	92.6	118.9
Mishi dhe përgatitja e mishit (CN 02 dhe CN 16)	0.5	0.7	1.8	5.1	13.1
Produkte të qumështit; vezët; mjalti natyral (CN 04)	1.4	0.7	1.0	1.3	1.8
Mbetjet nga industritë ushqimore; Ushqim foragjer (CN23)	1.6	2.7	1.6	1.6	1.8
Përgatitje të ndryshme të ngrënshme (CN 21)	0.8	0.6	0.8	1.3	1.3
Pijet, alkoolet dhe uthulla (CN 22)	23.1	34.7	40.5	39.5	32.8
Pemët dhe perimet e ngrënshme (CN 08 dhe CN 07)	22.7	15.8	21.7	19.2	15.9
Të tjera	49.8	44.7	32.6	32.0	33.2

Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB - MBPZhR

Importi i produkteve bujqësore sipas grupeve kryesore (%)

	Ø 2006-10	Ø 2011-15	2016-20	2021	2022
Importi (mil. €)	419.0	594.0	718.1	965.6	1,197.1
Pemët dhe perimet e ngrënshe (CN 08 dhe CN 07)	7.9	7.6	8.4	7.7	6.6
Mishi dhe përgatitja e mishit (CN 02 dhe CN 16)	12.7	13.5	12.8	12.4	14.1
Mbetjet nga industritë ushqimore; Ushqim foragjer (CN23)	2.9	2.9	2.6	3.0	2.8
Përgatitje të ndryshme të ngrënshe (CN 21)	6.4	7.8	9.5	9.4	8.9
Produkte të qumështit; vezët; mjalti natyral (CN 04)	7.0	6.3	6.5	6.1	6.4
Përgatitja nga drithërat, miell ose niseshte (CN 19)	7.9	8.4	9.0	9.2	8.8
Pijet, alkoolet dhe uthulla (CN 22)	11.8	10.2	10.6	11.9	11.3
Të tjera	43.4	43.3	40.5	40.3	41.0

Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB - MBPZHR

Eksporti i produkteve bujqësore sipas shteteve kryesore (%)

	Ø 2006-10	Ø 2011-15	2016-20	2021	2022
Eksporti (mil. €)	19.1	34.6	62.8	92.6	118.9
Bullgari	1.1	0.7	2.8	3.2	2.7
Gjermani	8.7	6.5	12.3	12.9	10.1
Maqedoni e Veriut	20.2	15.6	12.2	13.4	14.1
Serbi	11.8	8.2	9.0	9.8	7.7
Shqipëri	36.3	38.7	32.8	28.4	26.3
Zvicër	0.9	2.0	2.9	2.9	2.9
Të tjera	21.1	28.3	28.0	29.5	36.2

Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB - MBPZHR

Importi i produkteve bujqësore sipas shteteve kryesore (%)					
	Ø 2006-10	Ø 2011-15	2016-20	2021	2022
Importi (mil. €)	419.0	594.0	718.1	965.6	1,197.1
Bullgari	3.4	2.9	3.5	2.5	2.7
Gjermani	4.5	8.4	7.5	7.6	7.2
Kroaci	4.0	3.7	5.3	6.0	5.4
Maqedoni e Veriut	11.9	7.3	7.4	6.1	5.1
Poloni	2.5	3.5	6.8	6.9	5.6
Turqi	7.0	6.1	7.0	8.3	7.7
Të tjera	66.6	68.1	62.5	62.7	66.3

Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB - MBPZHR

Agro kreditë

Agro Kredi 2018 - 2022	Numri i kredive të disbursuara	Shuma totale e kredive të disbursuara (mil. €)	Kohëzgjatja e kredisë (muaj)	Norma mesatare e interesit (%)	Pjesëmarrja e Agro Kredive në gjithsej kreditë (%)
2018	26,403	91.3	Dec-39	6.0 - 28.5	1.3 - 64.5
2019	21,622	115.1	18 - 42	6.4 - 28.4	0.7 - 43.5
2020	22,958	83.2	18 - 40	5.3 - 28.6	0.5 - 36.7
2021	18,477	98.9	18 - 41.5	5.2 - 24	0.4 - 33
2022	19,962	108.3	18 - 41.9	5.2 - 28.6	0.4 - 38
Gjithsej	109,422	496.8			

Burimi: Bankat komerciale dhe IMF në Kosovë, përpunuar nga DAESB - MBPZHR


Përkrhja e sektorit të bujqësisë dhe zhvillimit rural

Pagesat direkte dhe grantet në mil. €					
	2018	2019	2020	2021	2022
Pagesa direkte	29.6	30.6	69.5	28.9	57.5
Grante	31	16.1	29.4	9.7	26.3
Gjithsej	60.6	46.7	96.4	38.7	83.8

Burimi: AZhB, përpunuar nga DAESB - MBPZhr

Pagesa direkte

Njësitë e mbështetura përmes pagesave direkte në vitin 2022



Pagesat direkte për kulturat bujqësore, verë dhe fidane						
		2018	2019	2020	2021	2022
Grurë	Numri i aplikuesve	10,683	8,872	11,044	6,862	11,331
	Numri i përfituesve	10,311	8,698	10,729	6,553	11,130
	Numri i ha të paguar	43,673	35,287	46,931	27,860	49,893
	Pagesa për ha	150	150	300	75	354
	Shuma totale e paguar	6,550,929	5,292,996	14,079,396	3,287,048	17,661,357
Farë gruri	Numri i aplikuesve	11	15	25	16	3
	Numri i përfituesve	11	15	24	14	3
	Numri i ha të paguar	458	562	869	528	161
	Pagesa për ha	250	250	500	250	304
	Shuma totale e paguar	114,204	140,395	434,540	131,913	48,895
Misër	Numri i aplikuesve	8,432	9,526	10,020	7,510	11,331
	Numri i përfituesve	8,165	9,370	9,808	7,224	11,651
	Numri i ha të paguar	21,519	27,483	28,493	18,934	35,876
	Pagesa për ha	150	150	300	150	329
	Shuma totale e paguar	3,227,784	4,122,464	8,547,885	2,840,082	11,803,368
Elb	Numri i aplikuesve	316	273	242	856	455
	Numri i përfituesve	306	267	233	820	437
	Numri i ha të paguar	518	488	442	2,054	753
	Pagesa për ha	150	150	300	150	204
	Shuma totale e paguar	77,688	73,194	132,645	308,040	153,708
Thekër	Numri i aplikuesve	83	70	59	182	131
	Numri i përfituesve	72	67	56	173	124
	Numri i ha të paguar	196	196	195	532	413
	Pagesa për ha	150	150	300	150	204
	Shuma totale e paguar	29,343	29,423	58,623	79,845	84,152
Tërshërë	Numri i aplikuesve	-	505	569	746	876

	Numri i përfituesve	-	485	538	706	829
	Numri i ha të paguar	-	928	1,321	1,665	1,695
	Pagesa për ha	-	150	300	150	204
	Shuma totale e paguar	-	139,161	396,261	249,689	345,727
Vreshta	Numri i aplikuesve	3,012	2,939	2,919	35	2,722
	Numri i përfituesve	2,949	2,900	2,880	11	2,694
	Numri i ha të paguar	2,580	2,989	3,080	197	2,724
	Pagesa për ha	1,000	1,000	2,000	125/200	1,054
					450/500	
	Shuma totale e paguar	2,580,250	2,988,810	6,160,400	2,520,246	2,870,896
Luledielli	Numri i aplikuesve	5	11	5	6	7
	Numri i përfituesve	4	11	3	6	4
	Numri i ha të paguar	5	97	40	20	46
	Pagesa për ha	150	150	300	150	224
	Shuma totale e paguar	749	14,621	12,036	2,946	10,192
Perime	Numri i aplikuesve	6,664	7,270	4,676	3,917	4,333
	Numri i përfituesve	6,435	7,099	4,481	3,802	4,155
	Numri i ha të paguar	8,977	8,295	9,210	6,870	7,014
	Pagesa për ha	300	300	600	400/500	204/554/
	Shuma totale e paguar	2,693,021	2,488,506	5,525,712	2,764,378	1
Pemishte ekzistuese	Numri i aplikuesve	5,278	3,557	3,166	2,929	3,620,710
	Numri i përfituesve	5,097	3,488	3,034	2,774	3,396
	Numri i ha të paguar	4,764	4,142	4,757	4,536	3,251
	Pagesa për ha	400	400	800	400	5,013
	Shuma totale e paguar	1,905,548	1,656,812	3,805,736	1,814,448	504
Bujqësi organike	Numri i aplikuesve	37	27	48	35	2,526,360
	Numri i përfituesve	24	26	38	11	20
	Numri i ha të paguar	443	1,050	1,672	197	9
	Pagesa për ha	500	500	1,000	125/200	198
					450/500	+50***

	Shuma totale e paguar	277,578	524,900	1,672,210	81,150	89,469
Verë	Numri i aplikuesve	16	15	18	17	18
	Numri i përfituesve	14	15	17	17	17
	Numri i litrave të paguara	4,769,358	9,734,385	5,711,290	9,148,751	7,702,215
	Pagesa për litër	0	0	0	0.08	0.04
	Shuma totale e paguar	190,774	389,375	228,452	731,900	308,089
Mjedër	Numri i aplikuesve	-	967	525	376	557
	Numri i përfituesve	-	594	386	320	365
	Numri i kg të paguara	-	898,547	1,055,337	864,717	1,153,245
	Pagesa për kg	-	0	0	0.12	0.15
	Shuma totale e paguar	-	71,883	168,854	103,766	172,987
Fidane	Numri i aplikuesve	16	14	13	17	19
	Numri i përfituesve	15	11	13	14	18
	Numri i fidaneve të paguara	483,230	435,200	469,194	607,348	592,448
	Pagesa për fidan	0.10/0.15/0.20	0.10/0.15/0.20	0.10/0.15/0.20	0.10/0.15/0.20	0.15/0.20/0.25
	Shuma totale e paguar	82,046	69,600	155,495	92,477	133,464
Bimë mjekësore dhe aromatike	Numri i aplikuesve	-	-	84	62	78
	Numri i përfituesve	-	-	70	56	54
	Numri i ha të paguara	-	-	248	60	39
	Pagesa për ha	-	-	450	450	504
	Shuma totale e paguar	-	-	111,479	26,933	19,601
Sigurimi bujqësor	Numri i aplikuesve	-	-	9	-	9
	Numri i përfituesve	-	-	5	-	9
	Numri i polisave të subvencionuara	-	-	5	-	9
	Pagesa për polisës, %	-	-	50	-	75
	Shuma totale e paguar	-	-	1,769	170	1,775

Burimi: AZhB – MBPZhR

Pagesat direkte për blegtori dhe qumësht

	2018	2019	2020	2021	2022	
Lopë qumështore	Numri i aplikuesve	7,595	6,775	7,027	6,210	5,773
	Numri i përfituesve	7,395	6,606	6,905	6,105	5,589
	Numri i krerëve të paguar	67,811	62,478	67,295	57,571	52,527
	Pagesa për krerë	70	70	140	85	90
	Shuma totale e paguar	4,746,770	4,373,460	9,421,300	4,893,535	4,727,430
Buallica	Numri i aplikuesve	-	6	5	5	4
	Numri i përfituesve	-	6	4	4	4
	Numri i krerëve të paguar	-	256	347	31	26
	Pagesa për krerë	-	70	140	85	90
	Shuma totale e paguar	-	17,920	48,580	2,635	2,340
Dele dhe dhi	Numri i aplikuesve	1,436	1,380	1,515	1,379	1,334
	Numri i përfituesve	1,378	1,355	1,469	1,329	1,296
	Numri i krerëve të paguar	153,241	160,768	170,985	149,784	141,792
	Pagesa për krerë	15	15	30	20	25
	Shuma totale e paguar	2,298,615	2,411,520	5,129,550	2,995,680	3,544,800
Dosa	Numri i aplikuesve	210	216	251	158	140
	Numri i përfituesve	202	211	235	133	116
	Numri i krerëve të paguar	1,366	1,405	1,877	1,042	895
	Pagesa për krerë	20	20	40	20	25
	Shuma totale e paguar	27,320	28,100	75,080	20,840	22,375
Bletë	Numri i aplikuesve	3,007	3,411	3,941	3,373	3,098
	Numri i përfituesve	2,764	3,238	3,634	3,133	3,016
	Numri i koshereve të paguara	164,739	204,730	233,227	192,551	190,579
	Pagesa për koshere	15	15	30	15	20/25
	Shuma totale e paguar	2,471,085	3,070,950	6,996,810	2,888,265	3,811,735
Pula vojse	Numri i aplikuesve	88	85	84	94	80

	Numri i përfituesve	81	82	84	77	73
	Numri i krerëve të paguar	1,023,671	1,181,829	1,310,235	1,120,349	871,909
	Pagesa për krerë	0.50/0.40	0.50/0.40	1.00/ 0.80	0.50/ 0.40	0.50/ 0.40
	Shuma totale e paguar	484,343	537,497	1,165,861	500,676	399,161
Thëllëza	Numri i aplikuesve	13	13	11	12	-
	Numri i përfituesve	13	9	10	11	-
	Numri i krerëve të paguar	36,560	28,088	23,678	16,245	-
	Pagesa për krerë	1	1	1	1	-
	Shuma totale e paguar	18,280	14,044	23,678	8,123	-
Qumësht	Numri i aplikuesve	3,116	1,836	1,062	1,197	1,314
	Numri i përfituesve	3,055	1,798	1,060	1,149	1,286
	Numri i litrave të paguara	34,522,414	38,664,480	24,464,477	44,835,136	46,183,417
	Pagesa për litër	0.06/0.04/0.02	0.06/0.04/0.02	0.12/0.08/0.04	0.06/ 0.04/ 0.02	0.07/0.04/0.02
	Shuma totale e paguar	1,736,944	2,041,145	2,570,392	2,358,351	2,840,801
Therje të raportuar të gjedhit	Numri i aplikuesve	28	14	11	8	11
	Numri i përfituesve	24	13	9	7	11
	Numri i krerëve të paguar	978	971	627	701	1,122
	Pagesa për krerë	50	50	100	50	50
	Shuma totale e paguar	48,900	48,550	62,700	35,050	56,100
Viça për majmëri	Numri i aplikuesve				744	5
	Numri i përfituesve				462	5
	Numri i krerëve të paguar				7,938	763,008
	Pagesa për krerë				10	0
	Shuma totale e paguar				79,380	152,602
Akuakulturë	Numri i aplikuesve	8	8	4	4	460
	Numri i përfituesve	5	8	3	4	395
	Numri i kg të paguar	430,341	447,990	167,376	551,571	7,732
	Pagesa për kg	0	0	0	0	25

Shuma totale e paguar	86,068	89,598	66,950	110,314	193,300
-----------------------	--------	--------	--------	---------	---------

Burimi: AZhB - MBPZhR

Masat e zhvillimit rural

Numri i aplikacioneve të miratuara	2018	2019	2020-2021	2022
Masa 1: Investimet në asetet fizike në ekonomitë bujqësore	383	303	188	382
Masa 3: Investimet në asetet fizike në përpunimin dhe tregtimin e produkteve bujqësore	27	7	19	6
Masa: Ujitje e tokave bujqësore	3	2	1	-
Masa 7: Diversifikimi i fermave dhe zhvillimi i bizneseve	130	150	96	97
Masa 5: Zbatimi i strategjive zhvillimore lokale-qasja Leader	13	11	-	6
Programi i veçantë	62	-	-	-
Gjithsej	618	473	304	

Burimi: AZhB, përpunuar nga DAESB - MBPZhR

Vlera e miratuara në €	2018	2019	2020-2021	2022
Masa 1: Investimet në asetet fizike në ekonomitë bujqësore	16,897,514	12,035,806	5,804,682	28,889,405
Masa 3: Investimet në asetet fizike në përpunimin dhe tregtimin e produkteve bujqësore	4,842,579	1,281,799	2,623,685	1,990,477
Masa: Ujitje e tokave bujqësore	475,413	320,000	109,815	-
Masa 7: Diversifikimi i fermave dhe zhvillimi i bizneseve	2,259,156	2,188,065	1,211,431	5,028,591
Masa 5: Zbatimi i strategjive zhvillimore lokale-qasja Leader	293,087	240,184	-	59695
Programi i veçantë	6,201,729	-	-	-
Gjithsej	30,969,478	16,065,854	9,749,613	35,968,168

Burimi: AZhB, përpunuar nga DAESB - MBPZhR